



URDHËR

Nr. 12, Datë 17/02/2017

PER MARRJEN E MASAVE PER SEZONIN E PROVIMEVE PER SEMESTRIN E PARE

Mbështetur në nenin 42 (Drejtuesi i Njësisë kryesore) si dhe nenin 25 (Departamenti) të ligjit nr. 80/2015, "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", duke marrë në konsideratë faktin se jemi në periudhën e provimeve të semestrit të parë,

urdhëroj

1. Përgjegjësit e Departamenteve të jenë të pranishëm dhe të ndjekin gjithë provimet e programeve të studimeve që përfshin departamenti përkatës.
2. Nëse konstatohet mungesë anëtari komisioni në ndonjë rast të veçantë Përgjegjësi i Departamentit të respektojë rigorozisht Rregulloren e studimeve të ciklit përkatës..
3. Përgjegjësit e Departamenteve të kordinojnë punën me administratën, sekretarinë mësimore dhe laborantët e Fakultetit për një proces provimesh të rregullt e me atmosfere krijuese.
4. Përgjegjësit e Departamenteve të japin porosi tek anëtarët e komisioneve që vlerësimi i studentëve të bëhet brenda afatit të përcaktuar në rregulloren e studimit.
5. Një ditë përpara zhvillimit të çdo provimi Përgjegjësit e Departamenteve në bashkëpunim me sekretarinë mësimore të komunikojnë me anëtarët e komisioneve për zhvillimin e provimit në ambientin dhe orën e përcaktuar.
6. Përgjegjësit e Departamenteve të kërkojnë nga pedagogët që t'i kushtohet vëmendje e veçantë vlerësimit korrekt të studentëve duke evidentuar në këtë mënyrë arritjet dhe mosarritjet e tyre.
7. Në përfundim të provimeve Përgjegjësit e Departamenteve të organizojnë takim me pedagogët në sejcilin program studimi që mbulojnë dhe të bëjnë analizën e tyre.
8. Në përfundim të provimeve Përgjegjësit e Departamenteve të bëjnë me shkrim vlerësimin e punës mësimore për sejcilin pedagog për procesin e semestrit të parë si dhe me paraqitjen në provim të tyre.
9. Për të gjithë ata që nuk do të respektojnë vendimet e marra nga Departamentet për sezonin e provimeve Përgjegjësit e Departamenteve të marrin masa konkrete disiplinore.
10. Zv.Dekani i Fakultetit të kordinojë veprimet për kontrollin e mbarëvajtjes së procesit të provimeve me Përgjegjësit e Departamenteve
11. Një kopje e këtij urdhëri t'i dërgohet Rektoratit.
12. Urdhëri të vendoset në ambientet e Fakultetit dhe në faqen web të UART.
13. Ky urdhër hynë në fuqi menjëherë.

Prof. Petrit MALAJ

DEKAN

FAKULTETI ARTIT SKENIK